

Korrik 2024 | Nr. 40

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

BULETINI MUJOR | Korrik 2024

BULETINI MUJOR

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al



Inspektori i Lartë i
Drejtësisë



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani
@ILD_Albania

PARAQITJA E VEPRIMTARISË SË ILD PËR VITIN 2023 NË KUVEND





PARAQITJA E VEPRIMTARISË SË ILD PËR VITIN 2023 NË KUVEND

E nderuar znj. Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Raporti vjetor dhe të dhënat e tij janë përpara jush dhe nuk do doja të bija në përsëritje, duke cituar gjërat që i keni në raport, por dëshiroj të evidentoj shkurt, se si në rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, shoh ecurinë e këtij institucioni përgjatë vitit 2023, parë kjo, edhe në raport me sfidat që ka hasur sistemi i drejtësisë, që prej miratimit të reformës në drejtësi në vitin 2016. Nën këtë optikë, jam munduar të përgatis një paraqitje të punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2023.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, brenda kompetencave të tij kushtetuese është angazhuar plotësisht, edhe përgjatë vitit 2023, që të ndikojë në përmirësimin e efikasitetit, transparencës, paanësisë, pavarësisë, profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë së sistemit gjyqësor në Shqipëri.

Me këto synime, ILD është përpjekur të adresojë një sërë çështjesh:

Së pari, nëpërmjet ushtrimit të kompetencave, në kuadër të sistemit të përgjegjshmërisë së magjistratëve, duke trajtuar dhe verifikuar një numër të lartë ankesash të qytetarëve. Më konkretisht, gjatë vitit 2023 janë verifikuar

Gjatë vitit 2023, u përfundua tërësisht trajtimi i fondit të ankesave të trashëguara nga institucionet e mëparshme, që kanë qenë përgjegjëse për procedimin disiplinor të magjistratëve, deri në ngritjen e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke dhënë kështu një mesazh të rëndësishëm tek të gjithë qytetarët dhe magjistratët, për ndërtimin e një tradite që shmang kulturën e harresës dhe pandëshkueshmërisë.

2340 ankesa të ardhura nga qytetarë apo institucione. Kjo do të thotë, se janë verifikuar 2340 praktika gjyqësore në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë e vendit.

Këtu duhet nënvizuar, se gjatë vitit 2023, u përfundua tërësisht trajtimi i fondit të ankesave të trashëguara nga institucionet e mëparshme, që kanë qenë përgjegjëse për procedimin disiplinor të magjistratëve, deri në ngritjen e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke dhënë kështu një mesazh të rëndësishëm tek të gjithë qytetarët dhe magjistratët, për ndërtimin e një tradite që shmang kulturën e harresës dhe pandëshkueshmërisë, pasi nga verifikimi

që ILD i ka bërë këtij fondi ankesash të trashëguara, janë hetuar dhe është kërkuar procedim disiplinor për disa magjistratë.

Dëshiroj të evidentoj këtu, se në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të ankuesve, 44% e ankesave ndaj magjistratëve janë pretendime për mosrespektim të ligjit material dhe procedural, ndërsa 34.5% të ankesave lidhen me pretendime ndaj vendimarrjeve të padrejta të magjistratëve gjatë shqyrtimit të çështjeve, 13.4% të ankesave lidhen me vonesa në arsyetimin e vendimeve gjyqësore dhe 8.1 % e ankesave lidhen me pretendime për zvarritje të gjykimit apo të veprimtarisë hetimore.





Nga 2340 ankesa të shqyrtuara, rezulton se pretendimet janë paraqitur në masën 68% për magistratë gjyqtarë, 7% për magistratë prokurorë dhe 22% për gjyqtarë dhe prokurorë së bashku. Për 77 ankesa nuk identifikohet subjekti ndaj të cilit ngrihen pretendime.

Nga informacioni statistikor i ankesave të shqyrtuara gjatë vitit 2023, vihet re se pretendimet ndaj magistratëve gjyqtarë që ushtrojnë detyrën pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë përbëjnë numrin më të lartë të ankesave. Ankesat për magistratët e kësaj gjykate janë 15% e ankesave të shqyrtuara në total, ndjekur nga pretendimet ndaj gjyqtarëve që ushtrojnë detyrën pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me rreth 13%. Renditja vijon me Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me rreth 6% të ankesave të

shqyrtuara në total.

Më pas renditen Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me një përfaqësim prej rreth 5% secila.

Ndërkohë, për magistratët e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë paraqitur rreth 2% e ankesave të shqyrtuara në total.

Gjykatat me më pak ankesa ndaj magistratëve të tyre janë: Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Gjykata e Lartë dhe Gjykata e



Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, me rreth 1% secila.

(SPAK) janë paraqitur rreth 1% e ankesave të shqyrtuara në total.

Sa i takon ankesave të shqyrtuara, mbi pretendimet ndaj magistratëve prokurorë, rezulton se për prokurorët që ushtrojnë detyrën në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është shënuar numri më i lartë i ankesave të ardhura, me rreth 6% e ankesave të shqyrtuara në total.

Numri më i ulët i ankesave është drejtuar për prokurorët që ushtrojnë detyrën në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, me rreth 0.5% e totalit të ankesave të shqyrtuara secila.

Renditja vijon me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier me rreth 2% secila. Për prokurorët e Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

Duke pasur parasysh rëndësinë që kanë në sistem një numër organesh, dëshiroj të evidentoj se gjatë veprimtarisë së ILD-së, në këto 4 vite, të dhënat mbi ankesat e paraqitura dhe te trajtuara nga ILD janë si më poshtë:

INSTITUCIONE	Trajtuar	Proces	Total
Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAК)	54	27	81
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJPSHPKKO)	27	14	41
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJPAKKO)	35	5	40
Gjykata e Lartë	66	30	96
Këshilli i Lartë Gjyqësor	13	5	18
Këshilli i Lartë i Prokurorisë	3	5	8
Prokurori i Përgjithshëm	5	5	10

Së dyti, një tjetër drejtim i punës së ILD-së, ka qenë zhvillimi i hetimeve disiplinore dhe kërkimi i procedimeve disiplinore. Konkretisht, janë zhvilluar 18 hetime disiplinore ndaj 25 magistratëve dhe janë zhvilluar 6 procedime disiplinore ndaj 6 magistratëve.

Së treti, një dimension i rëndësishëm i punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka qenë edhe kryerja e inspektimeve tematike. Për vitin 2023 janë zhvilluar 2 inspektime tematike, por dëshiroj të theksoj këtu, se që nga muaji Janar i këtij viti e deri tani, kanë përfunduar edhe 4 inspektime të tjera, në të gjitha gjykatat dhe zyrat e prokurorisë së vendit, përfshirë Gjykatën e Lartë, Gjykatat e Posaçme dhe Prokurorinë e Posaçme. Të gjitha raportet e inspektimeve gjenden në

faqen e internetit të institucionit. Sa i përket këtyre inspektimeve tematike, duhet theksuar se ka një reagim pozitiv nga organet e inspektuara, të cilat kanë implementuar rekomandimet e lëna nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Me këtë rast, dëshiroj t'i falenderoj edhe përpara jush, të gjitha institucionet për bashkëpunimin.

Transparenca e institucionit ka qenë një tjetër prioritet i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Për transparencën e arritur, Inspektori i Lartë të Drejtësisë renditet i pari ndër të gjitha institucionet e vendit, në “Indeksin e transparencës proaktive të institucioneve qendrore dhe të varësisë” për vitin 2023, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit, si institucioni që i ka të gjithë treguesit pozitivë të një transparence proak-

tive të lartë. Krahas rezultateve të vitit 2023, ndikojnë në efijencën e veprimtarisë së in-prioritetet e vendosura për vitin 2024 janë stitucioneve.

vijimësia dhe përmirësimi në të gjitha di-mensionet, e veprimtarisë së Zyrës së In-spektorit të Lartë të Drejtësisë. Finalizimi i trajtimit të fondit të ankesave të trashëguara, i ka dhënë më shumë frymëmarrje institucionit dhe presim që kjo të ndikojë në rritjen e efijencës, në kohë dhe me cilësi, përmes shqyrtimit të një num-ri më të lartë ankesash.

Nga ana tjetër, edhe pse janë bërë për-pjekje, implementimi i një sistemi el-ektronik bashkëkohor, kërkon më shumë avancim dhe bashkëveprim të ngushtë ndërmjet organeve, për miratimin e stand-ardeve teknike për çështje të teknologjisë së informacionit për organet e sistemit të drejtësisë, gjë e cila do të lehtësojë shkëmbi-min e informacionit, e rrjedhimisht do të

Dua ta sjell në vëmendje, se veprimtaria e vitit 2023 nuk ka qenë një proces i lehtë, e për rrjedhojë, edhe përgjatë këtij viti, ILD është përballur me një sërë sfidash në kuadër të ushtrimit të kompetencave të veta kushtetuese, ashtu si dhe organet e tjera të reja të sistemit të drejtësisë, të cilat duhet pranuar, nuk po funksionojnë sipas ka-paciteteve të tyre maksimale, si pasojë e një procesi të vazhdueshëm të jetësimit të reformës në drejtësi. Për të katërtin vit ra-dhazi, për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë mbetet domosdoshmëri plotësimi i trupës së inspektorëve, veçanërisht të profilit magistrat, si një mjet i pazëvendësueshëm për rritjen e mëtejshme të performancës së institucionit. Bashkëpunimi i institucioneve të tjera të drejtësisë në këtë drejtim, mbetet



Të nderuar deputetë,

Pavarësisht ndjeshmërive të ndryshme, duhet pranuar, se për shkak dhe në kuadër të kësaj reforme, sistemi i drejtësisë ka arritur rezultate, që tregojnë drejtimin e duhur, ku duhet të vazhdojë të ecë kjo reformë. Ka disa piketa që janë vendosur tashmë:

- Nëpërmjet procesit të vettingut janë arritur rezultate në lidhje me integritetin e magjistratëve;
- Janë bërë përpjekje për të forcuar pavarësinë e gjyqësorit duke reduktuar ndikimin politik dhe duke siguruar që magjistratët të ushtrojnë detyrën e tyre në mënyrë të pavarur;
- Janë krijuar institucione të reja si dhe është konceptuar një mekanizëm i mirëfilltë mbi zhvillimin dhe formimin profesional dhe të karrierës apo të përgjegjshmërisë së magjistratëve;
- Nëpërmjet ndryshimeve legislative janë krijuar institute apo mekanizma procedurale për të rritur efikasitetin e

pushtetit gjyqësor, duke përfshirë dixhitalizimin dhe efikasitetin e proceseve gjyqësore; apo

- Janë rritur standardet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në sistemin gjyqësor, duke siguruar një trajtim më të drejtë dhe më të barabartë për të gjithë qytetarët para ligjit.

Megjithatë, mbetet shumë për t'u bërë! Sot konstatohet se efienca e sistemit të drejtësisë nuk është në nivelin e saj më të mirë. Sot sistemi i drejtësisë po përballlet me mungesa të magjistratëve, si pasojë e zhvillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, vettingut. Kjo mungesë magjistratësh ka sjellë si pasojë, krijimin e një ngarkese shume te madhe të punës në gjykata dhe prokurori. Kjo ngarkesë padyshim ka sjellë edhe vonesa të jashtëzakonshme në shqyrtimin e çështjeve gjyqësore dhe kjo ka qenë një problematikë tjetër, që Inspektori i Lartë i Drejtësisë e ka adresuar nëpërmjet inspektimeve të veta përgjatë vitit 2023 dhe po vazhdon ta ketë prioritet edhe gjatë këtij viti.



Natyrish, sfida e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbetet balancimi dhe gjendja e një ekuilibri të drejtë, përmes identifikimit dhe vlerësimit nga njëra anë, te përgjegjësisë personale të magistratëve dhe nga ana tjetër, te kushteve apo ngarkesës së jashtëzakonshme të punës së tyre, për shkak të mungesës së burimeve njerëzore, infrastrukturës apo numrit të ulët të tyre në sistem. Edhe në këtë rast, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përpjekur të orientojë gjykatat apo zyrat e prokurorive me kriteret që duhen ndjekur, në raport me këto problematika apo vështirësi.

Por nga ana tjetër, koha ka qenë e konsiderueshme dhe e mjaftueshme, për ngritjen e organeve të reja të drejtësisë, si dhe bërjen e tyre funksionale. Gjithashtu, i gjithë sistemi gjyqësor është riorganizuar në kuadër të Hartës së Re Gjyqësore, duke sjellë edhe sfida, derisa sistemi i drejtësisë të gjejë balancën dhe standardin e duhur. Nuk duhet harruar, se gjatë këtyre viteve kemi qenë përpara aplikimit të një legjislacioni të ri, si material dhe procedural, ashtu dhe në raport me organizimin dhe funksionimin e organeve të reja të sistemit të drejtësisë. Padyshim, edhe zbatimi i këtij kuadri të ri ligjor, ka sjellë dhe debatet e veta profesionale, të reflektuara këto në praktika të ndryshme ad-

ministrative apo jurisprudencë.

Patjetër ka patur raste edhe të komentimit të vendimeve gjyqësore, kritika ndaj tyre, madje dhe deri në anatemimin e punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve apo të magistratëve nominalisht. Edhe nga opinioni publik. Edhe nga politika. Nuk është e lehtë për magistratët, por vlerësoj se ky është një proces dhe një sfidë që duhet të përballohet nga ana e tyre, pasi në këtë rast duhet të prevalojë e drejta e publikut mbi mbikëqyrjen e punës së tyre, pse jo edhe angazhimin në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin e administrimit të drejtësisë. Ajo që duhet thënë është se niveli shpeshherë i tejkaluar i kritikës ndaj punës së tyre, nuk i prek dhe as nuk i ul aspak garancitë që Kushtetuta ka dhënë për pavarësinë e gjyqtarëve e prokurorëve, në punën e diskrecionin e vendim-marrjes së tyre.

Për hir të së vërtetës, duhet thënë se të gjitha këto janë vështirësi, për të cilat qytetarët kanë treguar mirëkuptim maksimal dhe përtej të zakonshmes. Dhe përveç pritshmërive dhe besimit të lartë të publikut, mirëkuptimi i treguar deri tani është një tjetër përgjegjësi, e cila bie në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi organet e sistemit të drejtësisë.

Sfida e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbetet balancimi dhe gjendja e një ekuilibri të drejtë, përmes identifikimit dhe vlerësimit nga njëra anë, te përgjegjësisë personale të magistratëve dhe nga ana tjetër, te kushteve apo ngarkesës së jashtëzakonshme të punës së tyre, për shkak të mungesës së burimeve njerëzore, infrastrukturës apo numrit të ulët të tyre në sistem.

Dhe në këtë kuadër, sfida e organeve të reja të drejtësisë sot, mbetet pikërisht ruajtja e ekuilibrit ndërmjet pritshmërive, besimit dhe mirëkuptimit të publikut dhe faktorëve të tjerë në shoqëri, në raport me mundësinë reale të organeve të drejtësisë sot, për të ofruar përfundimisht një sistem drejtësie me integritet, të pavarur, eficient dhe të përgjegjshëm.

Nëse sistemi i drejtësisë përballet me mangësi apo problematika në kuadër të integritetit, pavarësisë apo eficientë, kjo nuk është përgjegjësi, vetëm e magistratëve. Këto problematika kërkojnë një adresim të qartë dhe zgjidhje të kujdesshme, në aspekt sistematik dhe nuk mund të adresohen vetëm nëpërmjet sistemit të përgjegjësisë së magistratëve, siç pretendohet vazhdimisht, mbi rolin dhe funksionet e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Dua ta theksoj se që nga momenti i krijimit, e deri në ditët e sotme, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka luajtur një rol proaktiv, në lidhje me identifikimin dhe hetimin e shkeljeve disiplinore të kryera nga ana e magistratëve. Dhe ky model pune do të vijojë edhe në vazhdim dhe gjithmonë, por gjithnjë duke respektuar parimet e një procesi të rregullt ligjor dhe mbështetur mbi një gur themeli të rëndësishëm të shtetit të së drejtës dhe demokracisë së një vendi, siç është ai i pavarësisë së sistemit gjyqësor.

Këto standarde pune të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë konfirmuar edhe gjatë vitit 2023 nga organet kompetente për shqyrtimin e tyre. Kështu, nga 1622 vendime të marra nga ILD për arkivim e mbyllje hetimi disiplinor, janë ankimuar vetëm 70 vendime arkivimi, ose shprehur në përqindje, janë ankimuar 4.3% e vendimeve të arkivimit. Ndërsa për 9 vendime për mbyllje të hetimit



disiplinor, nuk ka patur asnjë ankesë. Nga të gjitha ankimet e paraqitura ndaj vendimeve të ILD-së gjatë vitit 2023, rezultojnë 0 vendime të kthyer për shqyrtim, një rezultat që mbetet i pandryshueshëm, prej vitit të parë të punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pasi në të gjitha rastet, Këshillat apo KPA, kanë vendosur refuzimin si të pabazuar, të ankimit të paraqitur nga ankuesit ndaj vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, e për pasojë asnjë prej vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nuk është cënuar. Siç u evidencua edhe me sipër, sistemi i drejtësisë sot ka probleme. Në këtë kuadër, për të adresuar këtë fazë zhvillimi dhe problematikat e sistemit sot, në këndvështrimin tim personal, duhet të mbajmë në konsideratë faktin, si dhe duhet të kuptojmë qartë, se reforma në drejtësi është një sipërmarrje dhe angazhim shumë i rëndësishëm për shoqërinë shqiptare. Zbatimi i reformës në drejtësi është patjetër detyrë e institucioneve të drejtësisë. Por një proces kaq i thellë, i gjatë dhe kompleks, në kuptim të vlerave shoqërore dhe politike, që kjo reformë synon të kultivojë në shoqërinë shqiptare, kërkon domosdoshmërisht angazhimin e sistemit politik dhe institucional, si dhe të shoqërisë shqiptare në tërësi.

Ky proces duhet të kalojë nëpërmjet një stadi zhvillimi të sigurt, duke ofruar zgjidhje dhe vizion afatgjatë, duke analizuar të gjithë faktorët pozitivë apo negativë nga pikëpamja administrative, ligjore apo financiare, të cilat mund të ndikojnë në ngadalësimin apo ecurinë normale të tij.

Ky proces kërkon një vlerësim maksimal dhe zbatimin e një politike të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse:

- Në aspekt të konceptimit dhe zhvillimit të politikave, pasi para së gjithash reforma në drejtësi është konceptuar dhe udhëhequr nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, në kuadër të një procesi politik;
- Në aspekt të organizmit të ri institucional, sipas standardeve të Bashkimit Evropian, pasi reforma në drejtësi ka parashikuar një arkitekturë të re të sistemit të drejtësisë, si dhe
- Në aspektin procedural, që ka të bëjë me mekanizmat administrativë, ligjorë apo financiarë, në kuadër të implementimit dhe jetësimit të saj në praktikë.

Kjo qasje mund të kërkojë më shumë kohë, por është rruga më e sigurt drejt jetësimit kushtetues të reformës në drejtësi. Ky është këndvështrimi im personal në lidhje me situatën aktuale të ecurisë së Reformës së Drejtësisë, në raport me institucionet e drejtësisë sot.

Për këtë arsye, dua të theksoj edhe një herë, për sa kam qenë konsekuent në qëndrimet e mia të shprehura, si përpara Komisionit të Ligjeve, por edhe përpara kësaj sale të nderuar, duke i kërkuar Kuvendit të Republikës të ushtrojë rolin e tij tejet të rëndësishëm në kuadër të bashkëpunimit dhe koordinimit të veprimtarisë së institucioneve të drejtësisë, jo vetëm si hartues dhe ideator i reformës në drejtësi në Shqipëri, por edhe si promotor i fuqishëm i realizimit të saj.

Ju faleminderit për vëmendjen!



SESIONI I PYETJE-PËRGJIGJEVE ME INSPEKTORIN E LARTË TË DREJTËSISË Z. ARTUR METANI NË KUVENDIN E SHQIPËRISË

Deputeti Saimir Koreshi: Faleminderit e nderuar kryetare!

I nderuar, ju dhe në Komisionin e Ligjeve funksionon sot sistemi i prokurorisë dhe pranuat që keni vonesa dhe tejkalim të gjyqësori, flas sepse këtu është bërë një afateve në inspektim, ose në trajtimin e precedent që duket sikur sistemi i ankesave të ardhura për prokurorë dhe drejtësisë është vetëm SPAK, ndërkohë që gjyqtarë. Si është e mundur, sepse këtu sot, sistemi i Drejtësisë në 95 për qind nuk jo pa qëllim e them këtë, se shumë institu- është SPAK, por keqfunksionon? cione thonë e ka ky, e ka ai, e ka prokurori i Pyetja e dytë: A keni dijeni i nderuar, se përgjithshëm, e ka ILD. Pra është një ham- shumë gjyqtarë mbajnë praktika disamu- ulli në lidhje mesa ndodh. Këtë e them, se jore, deri në një vit dhe në fund fare pas një sa praktika kanë inspektorët tuaj i nderuar viti, pa nxjerrë asnjë datë bëjnë kthim ak- dhe sa kanë trajtuar gjatë 2023, në qoftë se tesh, e pambështetur kjo në kodin e proce- kanë pasur gjithë këtë punë, sepse nga ma-

durës civile, kthim aktesh mbas një viti, ku njerëzit presin të marrin drejtësi? A e dini ju i nderuar dhe a keni dijeni se shumë prokurorë më shpejt mbyllin çështjet penale se bëjnë kthim sendi? Pra, në qoftë se do të ketë dikush pa patentë i është bllokuar makina, edhe pasi është mbyllur çështja nuk kthen mjetin, e pas 25 kërkesave nga qytetarët dhe avokatët e ndryshëm të çështjes nuk ta kthen. Kur vetë këto akte dhe akte të tjera, si telefona që i marrin kur nuk ka veprime konkrete ndaj personave që janë sekuestruar telefona nuk i kthejnë më, oficerët e policisë gjyqësore nuk ua kthejnë më telefonat harrohen. Si është e mundur kjo, kur aktet nuk janë më në dobi, apo në shërbim të hetimit penal. A jeni në dijeni i nderuar se pas daljes së amnistisë, ata që kanë qenë me arrest shtëpie, nuk vijnë tek urdhri i ekzekutimit nga prokurori, por në kundërshtim me ligjin mbaheshin të arrestuar me arrest shtëpie? Por ka pas prej tyre në tejkalim afatesh që kanë qenë me burgim, si ka mundësi që prokurori nuk bën lëshim të urdhrit të ekzekutimit pas kërkesave të bëra nga avokatët përkatës, ose nga të burgosurit?

Pyetja e pestë: A keni nisur ndonjëherë hetim kryesisht për vonesat, afatet e gjyqtarëve dhe prokurorëve në dosjet që kanë në administrim, thënë kjo se shumë gjyqtarë dhe prokurorë absolutisht ndonjëherë thonë fakte se kanë ngarkesë, ngarkesë dhe nga kjo ngarkesë, ngarkesë, dalin datat, po të shikosh në Gjykatën e Tiranës njëherë në 6 muaj dhe po të shikosh të bësh një pjesëtim pasurie sot, kur e pamë që krimet më të mëdha ishin për tokat dhe po të bësh një pjesëtim pasurie mbi ata të

bashkëpronësisë, që janë ata të ligjit 7501 të kalosh fazën e parë, fazën e dytë të pjesëtimit, ka nga tre herë shkallë gjykimi, duhen 25 e kusur vjet dhe sa herë vjen drejt finishit të dëshmisë së trashëgimisë ka vdekur një nga bashkëpronarët. A ka verifikuar institucioni juaj ndonjë veprim kryesisht, si ka mundësi që zgjidhjet e martesave shkojnë deri në 3 vite dhe masat që janë marrë ndaj tyre dhe së fundmi, Si ju ka rezultuar harta e re gjyqësore sepse jo vetëm në perceptim, por në fakt pjesa e parë e pajtimit pra deri dje bëhej brenda 60 ditëve në apel në Vlorë mbarohej brenda një viti, një viti e gjysmë dhe 2 vjet, kurse sot në Apelin e Tiranës, ose në Apelin Administrativ thonë që po shqyrtojmë akoma dosjet e vitit 2017. Faleminderit!

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Faleminderit zoti deputet për pyetjet. Pyetjen e parë do doja ta ezauroja në fund, madje ju falënderoj realisht që e ngrite, sepse doja ta sqaroja njëherë e mirë çështjen e ankesave, afateve e trajtuara e kështu me radhë.

Po e filloj nga pyetja e dytë, a jeni në dijeni që gjyqtarët i mbajnë dosjet nga një vit dhe pastaj bëjnë kthim aktesh? Jo, unë mendoj, që i mbajnë edhe më shumë se një vit, ka raste. Dhe për këtë arsye ne kemi kryer përgjatë gjithë viteve që kanë kaluar edhe inspektime tematike edhe inspektime individuale për çështje të gjyqtarëve që kanë kaluar dosje apo çështje, që kanë kaluar afatet. Ka pasur raste të procedimeve të magistrarëve në këshilla, ka pasur edhe masa të marra nga këshillat në raport me procedimet disiplinore të kërkuara.

Pyetja tre. A e dini se prokurorët më shpejt mbarojnë hetimet, por nuk bëjnë kthim sëndi...?

Natyrisht problematika në sistem janë shumë, mundohemi t'i ndjekim të tëra edhe në bazë të ankesave edhe në bazë të inspektimeve tematike që kryejmë, apo në bazë të informacioneve që marrim nga mediat. Kjo është një çështje që do e shikojmë, nuk ka qenë pjesë e ankimeve në dijeninë time deri tani, apo nuk ka qenë pjesë thelbësore e inspektimeve, duke pasur parasysh që sistemi ka edhe shumë gjëra të tjera.

A jeni në dijeni se ka shumë të pandehur, se pas amnistisë....?

Po jam në dijeni edhe në bazë të informacionit që është bërë publik nga media edhe në bazë të një ankese që ka ardhur nga Avokati i

Popullit. Kemi nisur menjëherë verifikimin. Deri tashmë ka rezultuar 70 praktika që i japin dyshimin Inspektorit të Lartë të Drejtësisë se ka çështje për të verifikuar më tej. Janë praktika që janë në verifikim dhe do kalojnë më tej, sipas procedurave që parashikon ligji.

A keni nisur hetim kryesisht...po edhe kjo ka lidhje me pyetjen e dytë. Kemi kryer edhe inspektim tematik, por edhe inspektime individuale në raport me ankesat që kanë ardhur për gjyqtarët që janë në tejkalim të afateve. Madje sot ka përfunduar edhe hetimi i dy magistratëve, të cilët do dërgohen brenda muajit për procedim disiplinor para këshillave pikërisht për këto vonesa që po flasim. Harta e re gjyqësore si u rezulton...?

E thashë edhe në fjalë që harta e re padyshim ka krijuar sfida. Sipas informacionit që



ne kemi ka krijuar sfida edhe përsa i përket administrimit, edhe vonesave padyshim. Këto janë çështje, që ne jemi munduar ti trajtojmë, ti analizojmë edhe në bazë të inspektimeve tematike që ne mundemi të kryejmë. Por besoj që është herët për të vlerësuar nëse harta është e suksesshme apo jo.

Në lidhje me pyetjen e parë. Do doja të keni pak durim, sepse është përgjigje pak e gjatë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë në momentin e fillimit të detyrës në datën 01.02.2020, ka kërkuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorisë së Përgjithshme, dhe Ministrisë së Drejtësisë të dërgohen pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë:

- Ankesat e depozituara nga çdo person fizik, ose juridik lidhur me pretendimin për shkeljet e kryera nga ana e magjistratëve;
- Çdo dosje disiplinore në proces hetimi;
- Çdo problematikë të konstatuar që ka të bëjë me përmbushjen e detyrave funksionale të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- ♦ si dhe çdo çështje lidhur me inspektimet tematike dhe institucionale sipas kërkesave të nenit 194, pika 4, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

Në fillim të këtij procesi, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor është përcjellë fondi i parë i praktikave dokumentare i përbërë në total nga 757 ankesa, pjesa më e madhe e të cilave ndodhej në fazën e shqyrtimit fillestar. Në të njëjtën kohë, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor (dhe ish-KLD), vetëm gjatë periudhës Gusht-Shtator 2020, janë depozituar në total pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë edhe 1347 praktika të tjera të ish-KLD-së. Gjatë vitit 2020 në kuadër të aktiviteteve të ndryshme ndërgjegjësuere, pranë ILD-së janë depozituar gjithashtu edhe 950 ankesa të reja, duke sjellë si pasojë administrimin e një fondi arkivor të përbërë prej 3054 ankesa deri në datën 31.12.2020.

Ky fond i konsiderueshëm arkivor përbëhej nga ankesa të patrajuara, ankesa të trajtuara pjesërisht, apo në faza fillestare të shqyrtimit të tyre, Ndërkohë pjesë të këtij fondi arkivor ka pasur dhe një numër të konsiderueshëm rastesh apo praktikash për të cilat kishte nisur procesi i hetimit administrativ, por nuk ishte përfunduar nga ana e organeve të mëparshme, si Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm, Këshilli i Lartë Gjyqësor, apo Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Procedurat e ndjekura nga organet e mëparshme për

“Problematika në sistem janë shumë, mundohemi t’i ndjekim të tëra edhe në bazë të ankesave edhe në bazë të inspektimeve tematike që kryejmë, apo në bazë të informacioneve që marrim nga mediat” tha z. Metani.



trajtimin e këtyre praktikave dokumentare, për shkak të kompetencave të kufizuara apo të ndara ndërmjet organeve të ndryshme gjatë periudhës kalimtare, rezultoi se ish-in zhvilluar në mënyrë jo të plotë dhe të pjesshme.

Në funksion të trajtimit të këtyre ankesave apo praktikave të trashëguara nga ana e organeve të mëparshme, janë miratuar nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 3 (tre) urdhra me karakter të përgjithshëm për administrimin, kategorizimin, si dhe përcaktimin e mënyrës së trajtimit të tyre. Konkretisht:

Urdhri nr. 66, datë 28.09.2020 “Për ngritjen e grupit të punës, për administrimin dhe kategorizimin e ankesave të dorëzuara pranë organeve kompetente gjatë periudhës kalimtare, deri në ngritje të institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;

Urdhri nr. 98, datë 12.11.2020 “Për ngritjen e grupit të punës për vazhdimin e trajtimit të ankesave apo praktikave të përcjella nga Këshilli i Lartë Gjyqësor pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;

Urdhri nr. 41, datë 19.02.2021 “Për shpërndarjen e ankesave të mbartura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe të administruara pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Me miratimin e akteve të sipërpërmendura, është bërë administrimi dhe kategorizimi i të gjitha ankesave të dorëzuara pranë organeve kompetente gjatë periudhës kalimtare dhe të përcjella për trajtim pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ky kategorizim është bërë për të grupuar praktikën në mënyrë që të lehtësonte procesin e shqyrtimit. Në përfundim të procesit të kategorizimit, praktikën janë shpërndarë për trajtim sipas një rendi

përparësie bazuar në kritere si:

- data e dorëzimit;
- faza e trajtimit nga ana e organeve të mëparshme;
- tipologjia ose urgjenca e trajtimit të ankesës;
- respektimi i parimit të barazisë dhe objektivitetit, si dhe koha e nevojshme për shqyrtimin dhe vlerësimin e secilës praktikë dokumentare.

Ndërkohë, një kujdes i veçantë i është kushtuar ankesave dhe praktikave ku është propozuar, apo ka filluar hetimi disiplinor; ankesave në të cilat ngrihen pretendime për veprimtari të kryera jashtë afatit të parashkrimit; si dhe ankesave në fazën e verifikimit dhe të pezulluara deri në pritje të përfundimit të gjykimit nga gjykatat më të larta.

Nga data 01.02.2020 deri në datën 31.05.2024, procesi i shqyrtimit të ankesave, ka qenë një proces që ka tejkaluar pritshmërinë tonë lidhur ngarkesën normale të punës, si dhe kapacitet e burimeve njerëzore në dispozicion. ILD ka shqyrtuar 6499 ankesa (85 %) nga 7600 ankesa që përbën numrin e përgjithshëm të ankesave të depozituara në ILD. Gjatë vitit 2023 është përfunduar shqyrtimi dhe trajtimi i 2104 ankesave të trashëguara, duke mundur që ILD të mos mbartë aktualisht ankesa të trashëguara nga ana e institucioneve gjatë periudhës kalimtare (backlog), por të vijojë me efektivitet veprimtarinë, si dhe shqyrtimin e ankesave të ardhura në mënyrë të drejtpërdrejtë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Nga shqyrtimi i ankesave të fondit të trashëguar është vënë re se në ankesa para-

qiten pretendime për veprime apo mosveprime të cilat lidhen me çështje që i përkasin vendimmarrjeve të gjykatave apo veprimeve hetimore të hershme (2012-2017), të cilat në momentin e shqyrtimit nga ILD, kanë qenë parashkruar pasi koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar ka qenë më shumë se pesë vjet. Numri i ankesave të parashkruara në momentin kur janë regjistruar në ILD është 625, prej të cilave 99 janë parashkruar në ILD, ose 1.3%, e totalit të ankesave të trashëguara nga organet e mëparshme. Sot në ILD, nga ankesat e depozituara drejtpërsëdrejti në institucionin tonë, nuk rezulton asnjë rast të parashkruar, kjo pasi një kujdes të veçantë i është kushtuar respektimit të afatit ligjor prej pesë vitesh nga momenti kur pretendohet se ka ndodhur shkelja e pretenduar.

Shqyrtimi i çdo ankese është realizuar në mënyrë të paanshme, të pavarur dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit, për të siguruar nga njëra anë magjistratët për realizimin e një procesi të rregullt, dhe nga ana tjetër për të ofruar sigurinë se të gjitha ankesat do të shqyrtoheshin për të shmangur pandëshkueshmërinë. Në këtë drejtim janë hetuar 111 magjistratë, për 40 prej të cilëve është kërkuar fillimi i procedimit disiplinor pranë Këshillave. Për asnjë magjistrat të hetuar nuk ka patur shkelje të afateve të hetimit dhe as ankim të bërë nga magjistrati për shkelje të procedurës, dokumentacionit provues dhe afateve procedurale të hetimit. Prioritizimi i punës për të shqyrtuar pretendimet më të hershme në kohë, rëndësinë dhe pasojën e shkeljes, sigurisht që kanë ndikuar në respektimin e afateve të përcak-

tuara, por në asnjë rast nuk kanë ndikuar në vlerësimin e drejtë dhe të paanshëm në shqyrtimin e kriterëve të pranueshmërisë së ankesës, apo të kryerjes së procesit të verifikimit apo hetimit të plotë disiplinor. Ky nuk është vetëm një vlerësim i njëanshëm institucional nga ana e institucionit të ILD, por një tregues i qartë nëpërmjet vendimmarrjeve të Komisionit të Përkohshëm të Shqyrtimit të Ankimeve në Këshilla për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimmarrjes së ILD-së, ku për 4 vite radhazi, vijon të mos ketë asnjë ankim të pranuar ndaj 10 vendimeve të ankimuara për mbylljen e hetimit disiplinor.

Gjatë periudhës kohore 01.02.2020 deri në datën 31.05.2024, kapaciteti i burimeve njerëzore në ILD, që ka për objekt të veprimtarisë së tij trajtimin e ankesave, si dhe çështjet e hetimit disiplinor, apo zhvillimin e inspektimeve tematike/ institucionale, ka qenë dinamik dhe me ndryshime. Mungesa e interesit nga ana e magjistratëve gjyqtarë për komandimin e tyre në pozicionin inspektorë pranë ILD-së, ka përbërë në vetvete një pengesë në mbarëvajtjen e veprimtarisë. Për këtë arsye, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka vlerësuar të propozojë ndryshime ligjore për kriteret që duhet të plotësojnë magjistratët për komandim pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Konkretisht për vitin 2020, numri faktik i punonjësve në njësinë e inspektorëve ka qenë 4% duke trajtuar 173 ankesa nga 3054 ankesa të regjistruara pranë zyrës së ILD-së. Përgjatë këtij viti është zhvilluar edhe një inspektim tematik. Për vitin 2021

kapaciteti i burimeve njerëzore ka arritur në 31% duke trajtuar 1719 ankesa nga 4127 ankesa të regjistruara pranë zyrës së ILD-së. Për vitin 2022 numri i njësisë ka qenë 38 % të kapacitetit, duke trajtuar 1715 ankesa nga 3467 të regjistruara pranë zyrës së ILD-së. Përgjatë këtij viti janë zhvilluar edhe dy inspektime tematike. Ndërsa për vitin 2023 njësia e inspektorëve ka patur kapacitetin 55 %, duke trajtuar 2340 ankesa nga 3703 të regjistruara pranë zyrës së ILD-së. Ndërsa për 2024 kapaciteti i njësisë është 45% të kapacitetit duke trajtuar 552 ankesa nga 1600 ankesa të regjistruara pranë zyrës së ILD-së. Përgjatë këtij viti janë planifikuar të zhvillohen 6 inspektime tematike.

Në të njëjtën kohë, krahas trajtimit të ankesave, si dhe zhvillimit të inspektimeve tematike apo institucionale, synimi Zyrës së ILD përgjatë ushtrimit të funksioneve të tij kushtetuese dhe ligjore gjatë periudhës kohore 01.02.2020- 31.05.2024, është fokusuar edhe te ngritja dhe fuqizimi i veprimtarisë së tij, përmes përcaktimit të vizionit për drejtimin e punës, vendosjes së standardeve të punës, përcaktimit të kuadrit nënligjor për ushtrimin e veprimtarisë, plotësimin të vendeve vakante, vendosjes së kontakteve me institucionet e tjera të drejtësisë, fillimit të bashkëpunimit me aktorë ndërkombëtarë, si dhe ndërgjegjësimin të publikut mbi rolin e ILD-s dhe veprimtarinë e institucionit.

Megjithatë problematika kryesore, që Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka hasur gjatë kësaj periudhe kohore është mungesa

e burimeve njerëzore. Numri faktik i inspektorëve në 4 vite ka pësuar ndryshime dhe për vitin 2024, duke u reduktuar me 1 inspektor dhe numri faktik është 9 inspektorë nga 20 që përmban organika e institucionit. Nevoja për plotësimin e strukturës me inspektorë magjistratë, është paraqitur në mënyrë të vazhdueshme pranë këshillave përmes kërkesave për komandimin e magjistratëve, shpalljes së procedurave për rekrutimin e inspektorëve jomagjistratë.

Në mënyrë periodike, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar KLGj-së dhe KLP-së me kërkesa për komandimin e magjistratëve. Edhe pse procedurat janë shpallur nga ana e KLGj-së, nuk ka patur interes nga magjistratët, e për pasojë nuk ka asnjë gjyqtar të komanduar në ILD. Ndërsa nga ana e KLP-së janë komanduar 4 prokurorë, një prej të cilëve ka qenë i pezulluar për shkak të procedurave të rivlerësimit prej korrikut të viti 2021 deri në shkurt të vitit 2024. Kërkesa e fundit drejtuar KLP-së, nuk është shpallur nga ky Këshill pasi është vendosur mospranimi i kërkesës me arsyetimin e mungesës së prokurorëve me përvojë në sistem dhe se në ILD janë komanduar aktualisht disa prokurorë. Mungesa e inspektorëve është vërejtur që në fillim të veprimtarisë me shpalljen e parë të bërë nga KLGJ.

Për këtë arsye, nga ana e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë marrë masat e nevojshme për të propozuar ndryshime ligjore që synojnë zgjerimin e rrethit të subjekteve që përmbushin krite-

ret për të qenë inspektor. Ndryshimet ligjore janë paraqitur pranë Ministrisë së Drejtësisë në dhjetor të vitit 2020 dhe gjatë vitit 2021 janë depozituar në Kuvend. Nevoja për miratimin e tyre është theksuar edhe gjatë seancave dëgjimore të paraqitjes së raportit të veprimtarisë gjatë viteve 2021, 2022 dhe 2023 pranë Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Ende sot nismat e propozuara nga ana e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk janë futur në kalendarin e punimeve të Kuvendit.

Kryetarja e Kuvendit Lindita Nikolla: Pyetje Klotilda Bushka.

Deputetja Klotilda Bushka: Faleminderit kryetare!

Faleminderit zoti Metani për raportimin tuaj edhe për...Në fakt për përgjigjen e zaruara në lidhje me evadimin e ankesave dhe numrin e lartë të atyre të mbartura, kjo ishte edhe një nga pyetjet e mia. Në fakt do i ndaja pyetjet e mia në dy grupe, janë ankesat e mbartura në strukturat përpara reformës në drejtësi për inspektimet, për të cilat rezultoi se keni një evadim tërësor, nuk kemi më ankesa që kanë mbetur pending për t'u trajtuar, më pas janë ankesa të reja, një pjesë e të cilave është tashmë në procesin e hetimit disiplinor, flas për vitin e raportimit dhe më pas të rëndësishme për ne janë edhe inspektimet tematike. Tani unë do ndalem tek ankesat e subjekteve dhe inicimet që



Pkanë nisur me iniciativë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Përsa i takon hetimeve disiplinore rezultojnë që hetime disiplinore për 23 subjekte nga të cilat nisja e hetimit është bërë me ankesë, pra mbi bazën e një ankese, ndërkohë që për dy subjekte është filluar me iniciativë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Pyetja që kam është. A mendoni ju se keni nevojë të të shtoni procedurat e punës në mënyrë që ky numër të rritet, pra i atyre që ju filloni me iniciativë dhe të trajtoni edhe më shumë ankese të tjera? Sepse ne në komision e kemi diskutuar shpesh, ju keni të drejtë në fakt vërtet përpjekje të vazhdueshme për të plotësuar strukturën tuaj me inspektorë nga radhët e magjistratëve, gjë që e ka bërë të pamundur për efekt të mospasjes së interesit nga ana e magjistratëve edhe nga vakancat që janë krijuar në sistem dhe nga kriteret, të cilat

janë të tilla që duke u parë në fakt në përputhje me rrethanat faktike që ka sot sistemi, e bën të vështirë plotësimin me inspektorë nga radhët e magjistratëve. Për shembull, për periudhën e raportimit janë 10 vakanca dhe 6 vijnë për inspektorët nga radhët e magjistratëve, por ama në sistem janë edhe 4 pozicione vakante për inspektorë, që vijnë nga radhët e juristëve.

Në lidhje me rekrutimin e inspektorëve nga radhët e juristëve deri në raportimin e fundit nuk kishim ende ndonjë progres, nga momenti i raportimit në komision deri më sot keni plotësime të këtyre vakancave nga radhët e jomagjistratëve? Dhe a duhet që ndoshta të shihen, ndoshta të dakordësohen, sepse ndryshimi i kriterëve në ligj për inspektorët magjistratë janë me standardet e aplikueshme në vendet e BE, siç edhe të gjithë anëtarët e komisionit, siç edhe ju jeni një dijeni, kanë një lloj diskutimi me ekspertët e BE për një dakordësi, por

ndërkohë kjo dakordësi dhe ky proces parlamentar po ecën, por a mund të gjendet mënyra të tjera për të trajtuar ankesat pa pasur stafe nga inspektorët jomagjistratë në mënyrë që puna juaj të ecë dhe çështja tjetër ka të bëjë me inspektimet tematike? Thatë keni përfunduar 4 inspektime tematike në momentin që flasim, ndërkohë që në kohën e raportimit ishin dy, një për afatet e gjykimeve, shumë e rëndësishme në gjykimin tonë dhe çështje të tjera që ju i trajtuat në raportimin tuaj. Për çfarë janë dy inspektimet e tjera tematike dhe nëse në këto dy inspektime? Ka lidhje me shqetësimet që janë ngritur shpesh në komision, por tashmë së fundmi edhe në raportin e komitetit për parandalimin e torturës së Këshillit të Europës, ku është shumë problematike shifra e të paraburgosurve në raport me atë të të dënuarve në Shqipëri dhe të gjitha institucionet duhet të marrin masa për të adresuar këtë fenomen, sepse jo vetëm që ne i shkelim standardet nuk respektojmë të drejtat e njeriut, por nga ana tjetër jemi edhe mospërbushës të atyre detyrimeve që na vijnë nga ndërkombëtarët si vend anëtar të Këshillit të Europës. Dhe nëse nuk ka një trajtim ende nga ana juaj për këtë çështje, a do të jetë kjo në planin e inspektimeve për punën në vijim? Ndërkohë që është rekomandim në fakt. Në rezolutë, çështja e rekomandimeve është një tërësi procedurash në gjykimin të komplikuar edhe në ligj për mënyrën sesi zbatohen detyrat.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Në lidhje me pyetjen e parë, në lidhje me ankesat, a ka mundësi apo është rasti për të bërë një rivlerësim metodologjisë së

shqyrtimit të ankesave dhe efikasitetit të punës. Unë mendoj që përgjigjja është jo, jemi munduar ta zgjidhim këtë me mjete të tjera të organizimit të punës. Së pari njëherë, backlog-u që u hoq ishte një lehtësi shumë e madhe për punën e inspektorëve dhe kjo i ka dhënë një tjetër dinamikë dhe punës në institucion, sepse ankesat e vjetra kërkonin më shumë punë se një ankesë e zakonshme për shkak të vjetërsisë së informacionit të munguar. Kjo i ka dhënë një dimension tjetër efektivitetit të punës. Së dyti, kemi arritur një dakordësi me Këshillin e Lartë Gjyqësor, që Inspektori i Lartë i Drejtësisë, të ketë qasje në sistemin që përdorin gjykatat, sepse një nga fazat e punës më të rëndësishme që ka Inspektori i Lartë i Drejtësisë, që është verifikimi i ankesave, sot i merr shumë kohë sepse çojmë dhe marrim letra nga gjykata, ose në zyra prokurorie, shkon një muaj në varësi të çështjes.

Kështu që marrëveshja që kemi bërë me KLGJ-në është që ILD të ketë qasje në sistemin dhe i gjithë ky proces verifikimi do shmanget, pra s'do ketë më nevojë për një muaj ose dy muaj në varësi të ankesave, por do bëhet brenda pak ditësh. Kjo do t'i japë tjetër dinamikë dhe respektimit të afateve dhe trajtimin e më shumë ankesave. Nuk shoh për momentin nevojë për ndryshim metodologjie. Puna është dinamike dhe sjell dhe nevojë, por për momentin, këto dy përgjigje kam. Për pozicionet vakante, unë e kuptoj dhe reagimin e komisionit, nuk e keqkuptoj aspak, por kjo është një çështje që duhet trajtuar gjithsesi. Unë e kuptoj që sistemi mund të preket duke bërë ndryshime ligjore përsa i përket kritereve për magjistratë, por situa-

ta është e tillë. Nuk ka interes nga ata magjistratë që kanë mbi 13 vite eksperiencë pune. Në dijeninë time, ka prokurorë që kanë interes dhe për këtë arsye kam këmbëngulur që Këshilli i Lartë i Prokurorisë të shpallë vakanca. Ka një vit që Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk pranon ta kryejë këtë shpallje sipas arsyetimit të tyre, por gjithsesi kjo është situata. Tani, ndryshime ligjore nuk ka, shpallje nuk ka...Dhe unë e kam detyrim ligjor për inspektorët që gjysma e trupës së tyre të kenë magjistratë, por nuk është kjo më themelorja. Themelore është niveli profesional që sjellin inspektorët magjistratë, sidomos të profilit gjyqtar përse i përket punës që duhet të bëjë Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Sa i përket inspektorëve jomagjistratë, janë bërë dy herë thirrje. Procedura zgjat një vit, sepse merren informacione, që bëhet vetting i gjithë kandidaturave. Ka patur gjithmonë shumë kandidatura prandaj ka zgjatur dhe procesi. Për hir të së vërtetës, shpalljen e fundit e kemi bërë para dy muajsh ndoshta ka qenë një ditë pasi kemi raportuar pranë Komisionit të Ligjeve. Deri tani janë paraqitur pas përfundimit të aplikimit, rreth 19 kandidatura. Natyrisht ka filluar punë komisioni i trajtimit të çdo kandidature në përputhje me ligjin, por siç thashë procedura merr gati 10-11 muaj.

Për inspektimet tematike, inspektimet e para janë kryer inspektimet që i kemi detyrim nga ligji përse i përket çështjes së shortit të ndarjes së çështjeve në prokurori. Kemi kryer në 2022 dhe 2023 dhe këtë vit kemi filluar inspektime për këto çështje. Veç tyre, kemi inspektuar dhe rastin e zëvendësimit të prokurorëve, që është dhe

rasti që shfaq shqetësim sipas ankesave që kanë ardhur dhe nga qytetarët. Kemi trajtuar çështje lirimi para kohe me kusht, kemi trajtuar dhe një inspektim që na ka ardhur edhe si kërkesë nga partnerët ndërkombëtarë përse i përket zgjedhjes apo mundësisë për të shkurtuar procedurat gjyqësore. Këto janë kryesisht inspektimet tematike që janë dhe në raport. Ajo që dua të them se procedura e hartimit të planit të inspektimit bëhet në përputhje me metodologjinë e punës që e kanë miratuar inspektorët që punojnë në ILD. Së pari, kërkohet një informacion apo i dërgohet një letër këshillave, Ministrit të Drejtësisë apo Prokurorit të Përgjithshëm nëse ata kanë sugjerime për plane, apo inspektimeve tematike që mund të kryhen, sipas informacionit që ata kanë, apo mendimit që ata kanë. Kjo praktikë është ndjekur në çdo vit që prej fillimit të punës së ILD-së. Për hir të së vërtetës, dy institucione që kanë qenë gjithmonë permanent në kërkimin e mendimeve për inspektimet tematike ka qenë Prokurori i Përgjithshëm, më pas Ministri i Drejtësisë.

Këshillat nuk kanë qenë bashkëpunues përse i përket ideve dhe mendimeve që duhet të japin në lidhje me atë që duhet të inspektohet ose ndryshuar në sistem. Më pas, ky planifikim bazohet edhe në bazë të ankesave, pra cila ka qenë problematika më e madhe që vjen nga ankesat e qytetarëve dhe aty fokusojmë dhe ato pak burime njerëzore që kemi. Natyrisht, edhe në varësi të atyre çështjeve që publikohen në media që mund të jenë pjesë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që mund të adresohen nëpërmjet një inspektimi tematik. Kjo është metodologjia që ndjekim përse i për-

ket kryerjes së inspektimeve tematike, duke balancuar dhe ato pak burime njerëzore, sepse nga njëra anë janë dhe inspektimet tematike, nga ana tjetër janë dhe trajtimi i ankesave, hetimi disiplinor që kryhet që padyshim duan kohën e tyre edhe burimet e veta njerëzore. Në lidhje me çështjen që thatë, kjo nuk ka qenë pjesë e një inspektimi tematik deri më sot, por do e propozojmë në mbledhjen me inspektorët në varësi të të gjithë propozimeve që vijnë edhe brenda sistemit por edhe nga partnerët, pasi ata kanë kërkuar që ky inspektim që përmenda më sipër, të vazhdojë dhe për vitin 2025. Do e marrim në vlerësim dhe do e vlerësojmë në përputhje me ato mundësi që kemi.

Pyetja e deputetes Ina Zhupa: Ju si Inspektor i Lartë i Drejtësisë, a keni kryer ndonjë inspektim tematik ose në bazë ankese ne Prokurorinë e Posaçme mbi shkeljen e të drejtave të njeriut apo për standarde të dyfishta?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Siç e thashë edhe më parë, nga viti 2020 kur ka filluar ILD-ja deri më sot janë paraqitur 81 ankesa ndaj SPAK, janë trajtuar 54, dhe 27 janë në shqyrtim. Ndaj Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar kanë ardhur 41 ankesa, janë trajtuar 27 dhe 14 janë në shqyrtim. Për Gjykatën e Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar kanë ardhur 40 ankesa, 35 janë trajtuar dhe 5 janë në shqyrtim. Për Gjykatën e Lartë, kanë ardhur 96 ankesa, 66 janë trajtuar dhe 30 janë në shqyrtim. Për Këshillin e Lartë Gjyqësor, kanë ardhur 18 ankesa, 13 janë trajtuar dhe 5 janë në shqyrtim. Për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, kanë ardhur 8 ankesa, 3 janë trajtuar

dhe 5 janë në shqyrtim. Për Prokurorin e Përgjithshëm, kanë ardhur 10 ankesa, 5 janë trajtuar dhe 5 në shqyrtim.

Deputeti Flamur Noka: Nuk do të ju pyes në lidhje me skandalin e inceneratorëve, kur keni qenë drejtor juridik i kryeministrisë, por do ju bëj një pyetje në lidhje me një çështje që i takon ILD-së: A keni nisur ju, procedim disiplinor, për gjyqtaren Irena Maneku, Gjoka, Shpata, për fshehjen e dënimit me vendim gjykate në shtetin fqinj të Greqisë. Apo për mos deklarime të tjera të saj, siç janë detyrimet ligjore, apo për të hetuar mënyrën se si ajo në vitin 2004, shkoi në Itali, ndërkohë që 2 vite më parë, Greqia i kishte ndaluar asaj për shkak të dënimit dhe mashtrimeve lëvizjen në 27 vendet Shengen të BE-së. A mbani ju si ILD, si një organ i ri i drejtësisë së re, përgjegjësi se si kjo zonjë e dënuar në Greqi, të jetë sot përfaqësuesja e drejtësisë së re. Faleminderit!

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Së pari, ju nuk e bëtë pyetjen, por gjithsesi, do ta jap një përgjigje. Çështja është nën hetim dhe e dinë ata që po e hetojnë këtë çështje. Përsa i përket Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, apo Artur Metanit, të jeni i sigurt se nuk kam asnjë problem.

E dyta, me pyetjen. E ndjekim me prioritet çdo informacion publik që del për këdo edhe për gjyqtaren Irena Gjoka dhe po e trajtojmë në përputhje të ligjit 96, viti 2016 për statusin e Gjyqtarit dhe Prokurorit në Republikën e Shqipërisë.

Lindita Nikolla: Faleminderit!



RAPORTI I BE “SUNDIMI I LIGJIT” 2024

Më 25 korrik 2024 Komisioni Evropian në detyrë. Ligji parashikon që të paktën publikoi Raportin e tij vjetor mbi gjysma e inspektorëve duhet të jenë “Sundimin e ligjit” në vendet e BE-së e për magjistratë, duke siguruar kështu një ekuilibër të parë në vendet aspirante për libër të përshtatshëm, në përputhje me antarësim në BE, Shqipëria, Mali i Zi, standardet evropiane.

Maqedonia e Veriut dhe Serbia.

Puna e ILD-së në raportin vjetor për sundimin e ligjit për Shqipërinë:

“Inspektori i Lartë i Drejtësisë është funksional, por numri i madh i vakancave të inspektorëve magjistratë mbetet shqetësim.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj

gjyqtarëve dhe prokurorëve. Zyra e ILD ka 20 inspektorë në organikë. Megjithatë vetëm 9 inspektorë nga 20, janë aktualisht

inspektorë-magjistratë, sidomos gjyqtarë rezultojnë sfida, sepse me përfundimin e mandatit të inspektorit, perspektiva e avancimit në karrierë për magjistratin në fjalë mbetet e kufizuar.

Stoku u ankesave të trashëguara u përfundua nga ILD në vitin 2023, duke trajtuar të 2104 çështjet, nga të cilat 1072 u trajtuan vetëm gjatë vitit 2023.

Sa i takon aktivitetit disiplinor, ILD ka kërkuar nga Këshillat vendosjen e masave disiplinore për 6 magjistratë.”



NJË KOMUNIKIM DIPLOMATIK PËR DREJTËSINË NDIHMON PROCESIN INTEGRUES TË VENDIT NË BE

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Me- spektorit të Lartë të Drejtësisë në kuadër tani ishte i ftuar i Akademisë Diplomatike të reformës në drejtësi, sfidat e ecures së të Ministrisë për Evropën dhe Punët e saj dhe diplomacia në raport me të”. Jashtme, ku mbajti ligjëratën “Roli i In-





Z. Metani vuri në dukje rëndësinë që duhet shtetin e së drejtës e sundimin e ligjit, që u të marrë komunikimi edhe diplomatik për konkretizua me përfshirjen për herë të drejtësinë në Shqipëri, vecanërisht në fazën parë, të Shqipërisë e vendeve të tjera as-ku ndodhen negociatat e Shqipërisë me BE- pirante të rajonit, në Raportin vjetor të në, si dhe vëmendjen që ka Unioni për Komisionit European mbi sundimin e ligjit.





“Jam i kënaqur me vlerësimet në raport sa i stitucionet e drejtësisë, në mënyrë që të takon ILD-së dhe mendoj që kjo na inku- vijë panorama e plotë e sistemit. rajon për të avancuar më shpejt në drejtim Nga vizitat e punës që kam patur tek in- të përvetësimit e konsolidimit të stand- stitucione homologe e të drejtësisë të ardeve të BE mbi sundimin e ligjit e shtetin vendeve të Bashkimit Evropian e jo vetëm, e së drejtës. Mendoj se kontaktet që ven- kam vënë re interes të lartë për të kuptuar dosim përmes takimit të sotëm na shërbe- zhvillimet e drejtësisë në Shqipëri dhe jnë, që bashkë me ambasadorët, të prezan- reformën që është realizuar ”, tha z. Me- tohet sa më mirë Shqipëria, edhe në tani pasi bëri edhe një paraqitje të drejtim të asaj cfarë po ndodh me funksioneve të Zyrës së inspektorit të Lartë reformën në drejtësi. E për këtë, komuniki- të Drejtësisë. me të tilla duhet të bëhen me të gjitha in-

Jam i kënaqur me vlerësimet në raport sa i takon ILD-së dhe mendoj që kjo na inkurajon për të avancuar më shpejt në drejtim të përvetësimit e konsolidimit të standardeve të BE mbi sundimin e ligjit e shtetin e së drejtës. Mendoj se kontaktet që vendosim përmes takimit të sotëm na shërbejnë, që bashkë me ambasadorët, të prezantohet sa më mirë Shqipëria, edhe në drejtim të asaj cfarë po ndodh me reformën në drejtësi.



Ambasadori i Shqipërisë në Bashkimin Europian dhe Mbretërinë e Belgjikës, z.Ferit Hoxha nënvizoi vëmendjen e BE për shtetin e drejtës në Shqipëri, e reflektuar edhe përmes Raportit për sundimin e ligjit, që u publikua një ditë më parë dhe vlerësoi idenë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për këtë lloj bashkëpunimi me diplomacinë për të shpjeguar ecurinë e zhvillimet e reformës në

drejtësi në vend dhe prezantuar rezultatet sepse mbi ato do të gjykohet procesi i negociimit për antarësimin në BE.

Z. Metani iu përgjigj interesimit të audiencës në sallë edhe asaj të përfaqësuesve diplomatikë të Shqipërisë në botë, që e ndoqën online aktivitetin.



KORRIKU I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit **Korrik** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **95 ankesa**, **92** nga të cilat janë paraqitur nga qytetarë dhe **3 ankesa** nga institucione. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit korrik 2024.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët. Ato ndodhen në faza të ndryshme trajtimi, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

ARKIVIME	VERIFIKIME	PROCESI DISIPLINOR
<p>149 vendime nga 209 praktika të trajtuara konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> 117 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar, nga 157 praktika të shqyrtuara (40 praktika të bashkuara) 32 vendime arkivimi pas verifikimit, nga 52 praktika të trajtuara (20 ankesa të bashkuara) 	<p>32 vendime verifikimi</p>	<ul style="list-style-type: none"> 5 vendime për fillim hetimi disiplinor për 5 magjistratë (prokurorë) 1 kërkesë për procedim disiplinor (prokuror)

ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankesë, i cili:

- * mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- * të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.


* mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevoje, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin “Si pranohen ankesat”.

SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Korrik 2024** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **10 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarrtshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.





Gjatë asistimit të ankuesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



Gjatë muajit Korrik 2024, Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun:

- ⇒ ka pritur 20 ankues, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe
- ⇒ ka realizuar 23 telefonata me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuar për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga

qytetarët, personat juridikë, grupet e interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve,

SHIFRA MUJORE

Gjatë muajit Korrik 2024, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **11 kërkesa për informacion**, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuar t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).

ILD NË TWITTER


Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani reposted

IDM Albania @IDM_Albania

IDM Morning Briefing | Bashkëbisedim me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Z. Artur Metani.

📌 Nisma "IDM Morning Briefings", mbështetet nga Hanns Seidel Stiftung, Zyra Tiranë.

@ILD_Albania



9:20 PM · 5.724 · 164 Views

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani reposted

USEmbassyTirana @USEmbassyTirana

A delegation of senior judges and a senior prosecutor from the United States concluded their visit to Tirana today. 1/3



4:18 PM · 12.724 From Earth · 1.1K Views

Inspektori i Lartë i Drejtësisë... · 15.7.24

pse jo edhe angazhimin në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin e administrimit të drejtësisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë... · 15.7.24

Ajo që duhet thënë është se niveli shpeshherë i tejkaluar i kritikës ndaj punës së tyre, nuk i prek dhe as nuk i ul aspekt garantitë që Kushtetuta ka dhënë për pavarësinë e gjyqtarëve e prokurorëve, në punën e diskrecionin e vendimmarrjes së tyre.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M... @ILD_Albania

Në kuvend për raportimin vjetor. "... ka patur raste edhe të komentimit të vendimeve gjyqësore, kritika ndaj tyre, madje dhe deri në anatemimin e punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve apo të magistratëve nominalisht. Edhe nga opinionin publik. Edhe nga politika.

Translate post



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M... @ILD_Albania

Metani: ... ka patur raste edhe të komentimit të vendimeve gjyqësore, kritika ndaj tyre, madje dhe deri në anatemimin e punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve apo të magistratëve nominalisht. Edhe nga opinionin publik. Edhe nga politika. Nuk është e lehtë për magistratët...

Translate post



4:58 PM · 15.724 From Earth · 104 Views

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M... @ILD_Albania

FJALA E Z. METANI GJATË RAPORTIMIT VJETOR NË KUVENDIN E SHQIPËRISË -

Translate post



From ild.al

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M... @ILD_Albania

SESIONI I PYETJE-PËRGJIGJEVE ME INSPEKTORIN E LARTË TË DREJTËSISË Z. ARTUR METANI NË KUVENDIN E SHQIPËRISË

Translate post



From ild.al

8:52 AM · 17.724 From Earth · 75 Views

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artu... · 5d

Sa i takon pëlqyeshmërisë së pozicionit për inspektorë-magjistratë, sidomos gjyqtarë rezultojnë sfida, sepse me përfundimin e mandatit të inspektorit, perspektiva e avancimit në karrierë për magistratin në fjalë mbetet e kufizuar.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artu... · 5d

Sa i takon aktivitetit disiplinor, ILD ka kërkuar nga Këshillat vendosjen e masave disiplinore për 6 magjistratë.

#RuleofLawReport #EU #ILD

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M... @ILD_Albania

Puna e #ILD në raportin vjetor për sundimin e ligjit për Shqipërinë: "Inspektori i Lartë i Drejtësisë është funksional, por numri i madh i vakancave të inspektorëve magjistratë mbetet shqetësim.

Translate post

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M... @ILD_Albania

Kënaqësi të komunikojta me ambasadorë e diplomatë shqiptarë mbi veprimtarinë e ILD dhe nevojën e një komunikimi diplomatik p drejtësinë dhe rezultatet e saj. Faleminderi Ministër @IgliHasani për mbështetjen nda idesë dhe ekipit të @AlbanianDiplo @HoxhaFer

Translate post



2:30 PM · 25.724 From Earth · 968 Views

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M... @ILD_Albania

Z. Metani vuri në dukje rëndësinë që duhet të marrë komunikimi edhe diplomatik për drejtësinë në Shqipëri. #ILD

@AlbanianDiplo

Translate post




NJE KOMUNIKIM DIPLOMATIK PËR DREJTËSINË NDIHMON...

From ild.al

2:42 PM · 25.724 From Earth · 878 Views

14 Reposts 30 Likes



RULE of LAW REPORT 2024

COUNTRY CHAPTER ABSTRACTS AND RECOMMENDATIONS

KORRIK 2024

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

© ILD




KONTAKT ILD

WEB: ild.al

EMAIL: info@ild.al

ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)

[Kliko për të ndjekur spotin prezantues të ILD](#)

